

HELSINKI COMMITTEE FOR HUMAN RIGHTS



Shkup, më 5 maj 2017

RAPORTI I VEÇANTË MBI VEPRAT E MUNDSHME PENALE

TË IDENTIFIKUARA

TË KRYERA GJATË DHUNËS NË KUVEND MË 27 PRILL 2017

Menjëherë pas zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit të RM-së nga shumica parlamentare, më 27 prill 2017, rreth orës 19, organizatorët dhe pjesëmarrësit në protestën “Për Maqedoni të përbashkët” hynë me dhunë në ndërtesën e Kuvendit. Duket qartë, nga videot e shumta të xhiruar, se nëpunësit e policisë të obliguar për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe sigurisë së të pranishmëve në sallat e Kuvendit, lejuan hyrje të papenguar të protestuesve. Hyrja u është lejuar edhe personave të cilët ishin të maskuar me maska dhe të cilët me vete mbanin objekte të forta dhe të mprehta me qëllim që të rrezikonin integritetin fizik të të pranishmëve në Kuvend. Shumë shpejt pas hyrjes janë lënduar dhjetëra deputetë (prej të cilëve minimum një me lëndime të rënda), gazetarë, mbi 70 qytetarë dhe mbi 20 nëpunës policorë. Ministria për Punë të Brendshme në koordinim me Prokurorinë Themelore Publike Shkup identifikoi dhjetëra kryerës të veprave penale. Një pjesë e tyre janë arrestuar, ndërsa për një pjesë është përcaktuar arrest shtëpiak dhe masa të tjera të sigurisë. Tani për tani, kryerësit e identifikuar janë të dyshuar se kanë kryer tri lloje të veprave penale – Pjesëmarrje në turmë e cila pengon personin zyrtar në kryerjen e veprimtarisë zyrtare, Pjesëmarrje në turmë e cila do të kryejë vepër penale dhe Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm.

Ky raport i veçantë u dedikohet veprave penale të identifikuar nëpërmjet fotografive, materialeve audio dhe videove dhe dëshmimeve, si dhe të veprave penale për të cilat ekzistojnë dyshime, por ende nuk është hetuar se a janë kryer dhe prej kujt. Raporti i shqyrton shkeljet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe që sanksionohen me Kodin Penal. Teksti i dedikohet informimit të publikut, por edhe si mjet i cili organeve të drejtësisë mund t’u shërbejë gjatë marrjes së vendimeve në lidhje me kualifikimin e veprave penale dhe individualizimin e përgjegjësisë penale gjatë shqiptimit të dënimeve nga gjykata. Raporti përmban 27 vepra penale gjithsej, prej të cilave për 17 ekzistojnë tashmë një numër i theksueshëm dëshmesh dhe 10 vepra penale për të cilat ekziston dyshime se janë kryer. Kryerësit e mundshëm janë ndarë në katër grupe: 1) organizatorë, 2) kryerës, 3) nëpunës policorë dhe 4) udhëheqës të tyre. Veprat penale dalin nga 8 kapitujt e Kodit Penal, dhe janë drejtuar kundër: 1) jetës dhe trupit; 2) të drejtave dhe lirive të qytetarëve; 3) pronës; 4) sigurisë; 5) shtetit; 6) obligimit zyrtar; 7) gjyqësorit dhe 8) rendit publik. Roli i organeve gjyqësore është të përcaktojnë se a janë bërë dhe cilat prej veprave penale janë kryer apo ka pasur përpjekje për kryerje të tyre dhe të mos lejojnë kualifikim të gabuar, kolektivizim të përgjegjësisë dhe sanksionin afrofe.

SHKELJA E TË DREJTAVE DHE E LIRIVE TË GARANTUARA ME KUSHTETUTËN E RM-SË	
E DREJTË APO LIRI	TË SHKELURA SEPSE
E drejta e jetës Neni 10	Policia nuk e përmbushi obligimin e vet pozitiv që ta mbrojtë jetën e deputetëve të sulmuar.
E drejta e integritetit moral dhe fizik Neni 11	Policia është pasive, nuk ndërmer veprime zyrtare për mbrojtje dhe me vetëdije nuk i zbaton autorizimet e veta.
E drejta e lirisë Neni 12	Një pjesë e deputetëve më tepër se tri orë ishin të privuar në mënyrë të paligjshme nga liria.
E drejta e kryerjes së funksionit publik Neni 23	Sulmi i organizuar ishte drejtuar kah suspendimit të të drejtës së kryetarit të ri të zgjedhur të Kuvendit, por edhe të deputetëve të tjerë.
E drejta e mbrojtjes shëndetësore Neni 39	Protestuesit nuk lejuan qasje në kohë të automjeteve mjekësore. Policia reagoi shumë vonë.

KATEGORI TË KRYERËSVE TË VEPRAVE PENALE	
1. Organizatorë	Persona për të cilët ekziston dyshimi se kanë porositur, planifikuar, dakorduar apo nxitur kryerjen e veprave penale. Hetimi duhet t'i përfshijë organizatorët e protestave "Për Maqedoni të përbashkët" për përcaktim të statusit të mundshëm të organizatorëve në kuptim penal, si dhe të partisë VMRO DPMNE për përcaktim të statusit të mundshëm të nxitësve në kuptimin penal.
2. Kryerës	Të gjithë personat që në Kuvend hynë me dhunë dhe për të cilët ekzistojnë fotografi, regjistrime video dhe audio, dëshmi ose pranim se kanë kryer veprë penale, sulmuesit e drejtpërdrejtë dhe personat që kanë mundësuar, ndihmuar apo fshehur veprat penale.
3. Nëpunësit policorë	Të gjithë që nuk i zbatuan autorizimet zyrtare, ndihmuar, i keqpërdorën autorizimet dhe pozitën e vet dhe mundësuan kryerjen e veprave penale.
4. Udhëheqësit e nëpunësve policorë	Të gjithë në hierarkinë e Shtabit Operativ të MPB-së për të cilët ekziston dyshimi se kanë dhënë urdhra të paligjshme, ose me vetëdije kanë hequr dorë i dhënies së urdhrave të ligjshme dhe të obligueshme.

I. VEPRA PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT	
KODI PENAL	DËSHMI, DYSHIME TË BAZUARA, PËRGJEGJËSI DHE DËNIM
1. Përpjekje për vrasje Neni 123 në lidhje me Nenin 19	Dëshmi janë lëndimet e rënda trupore, fotot dhe video-materialet dhe dëshmitë për përpjekjen për vrasje të deputetit Zijandin Sela, si dhe dëshmitë e deputetëve të sulmuar viktimë. <u>Përgjegjësi</u> : organizatorët dhe kryerësit <u>Dënimi</u> : minimum 5 vjet burg
2. Lëndim trupor Neni 130	Dëshmi janë lëndimet më të lehta trupore (te personat me leje për hyrje në Kuvend) në formën e ënjtjeve, përskuqjeve, mavijosjeve apo çjerrjeve ku kryerësi ka vepruar në mënyrë individuale. Ndjekja ndërmerret me padi private. <u>Përgjegjësi</u> : kryerësit dhe shteti (për dëmin) <u>Dënimi</u> : dënim me të holla ose burg deri në 3 vjet
3. Lëndim i rëndë trupor Neni 131	Dëshmi janë lëndimet më të rënda trupore dhe shkatërrimi i shëndetit fizik dhe psikik të viktimave. <u>Përgjegjësi</u> : organizatorët, kryerësit dhe shteti (për dënim) <u>Dënimi</u> : burg nga 6 muaj deri në 5 vjet
4. Pjesëmarrje në rrahje Neni 132	Dëshmi janë fotot dhe video-materialet të pjesëmarrjeve në rrahje në të cilat disa viktimat janë lënduar më rëndë, duke përfshirë edhe lëndimet te viktimat të cilët kanë zbatuar mbrojtjen e nevojshme prandaj nuk mbajnë përgjegjësi penale. <u>Përgjegjësi</u> : kryerësit <u>Dënimi</u> : burg nga 3 muaj deri në 3 vjet
5. Rrezikim me mjete të rrezikshme gjatë rrahjes ose zënkës Neni 133	Dëshmi janë fotot dhe video-materialet nëpërmjet të cilave mund të identifikohen të gjithë personat të cilët gjatë rrahjeve apo grindjeve kanë marrë mjete të rrezikshme (p.sh. bazament i video-kamerës, pjesë të mobilieve, shufra metalike etj.) <u>Përgjegjësi</u> : kryerësit <u>Dënimi</u> : dënim me të holla ose burg deri në 3 vjet

<p>6. Pasqyrimi në rrezik</p> <p>Neni 134</p>	<p>Dëshmi janë fotot dhe video-materialet, si dhe dëshmitë për të gjithë që lanë pa ndihmë viktimat në gjendje të rrezikut për jetën, që e shkaktuan vetë. Kryerësit janë edhe personat që nuk lejuan evakuim dhe qasje të ndihmës së shpejtë te viktimat.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: burg nga 3 muaj deri në 3 vjet ose deri në 5 vjet në viktima ka pësuar lëndim të rëndë trupor</p>
<p>7. Mosdhënia e ndihmës</p> <p>Neni 136</p>	<p>Dëshmi janë fotot dhe video-materialet dhe dëshmitë për personat që nuk u dhanë ndihmë viktimave të cilat gjendeshin në rrezik për jetën (nuk ka përgjegjësi penale në rastin kur këtë nuk mund ta kryenin pa pasur rrezik për ta apo për tjetër).</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: të pranishmit në Kuvend</p> <p><u>Dënimi</u>: dënim me të holla ose burgim deri 1 vit</p>

II. VEPRA PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE QYTETARIT

<p>8. Privim i paligjshëm nga liria</p> <p>Neni 140</p>	<p>Dëshmi janë fotot dhe video-materialet dhe dëshmitë për personat që një pjesë të deputetëve i mbanin të burgosur dhe ua morë apo ua kufizuan të drejtën e lëvizjes.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: dënim me të holla ose burgim deri 1 vit</p>
<p>9. Rrezikimi i sigurisë</p> <p>Neni 144</p>	<p>Dëshmi janë fotot dhe video-materialet dhe dëshmitë për personat që i kërcënuan seriozisht deputetët se do të sulmojnë jetën e tyre ose trupin ose jetën dhe trupin e personave të tyre të afërm. Për kërcënim ndaj një personi ndjekja ndërmerret me padi private, ndërsa ndaj më tepër personave ndërmerret me obligim zyrtar.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: dënim me të holla ose burgim deri në 6 muaj ose në 3 vjet nëse kërcënimi ka qenë ndaj më tepër personave</p>

III. VEPRA PENALE KUNDËR PRONËS

10. Dëmtimi i objekteve të huaja Neni 243	Dëshmi janë fotot dhe video-materialet për personat që dëmtuan, shkatërruan ose bënë të përdorshëm/përdorshme objektin/objektet në Kuvend. <u>Përgjegjësi</u> : kryerësit <u>Dënimi</u> : dënim me të holla ose burgim deri në 3 vjet apo deri në 5 vjet nëse dëmi ka qenë i theksueshëm
---	--

IV. VEPRA PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PRONËS

11. Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm Neni 288	Dëshmi janë fotot dhe video-materialet për të gjithë që me veprim me rrezik të përgjithshëm (p.sh. heqje e barrikadave) apo mjete (p.sh. bazament të video-kamerave dhe shufrave metalike) shkaktuan rrezik të theksueshëm për jetën apo trupin e një numri të madh të pranishmish në Kuvend dhe për pronën në shkallë të madhe. <u>Përgjegjësi</u> : kryerësit <u>Dënimi</u> : burgim nga 1 deri në 5 vjet
--	---

V. VEPRA PENALE KUNDËR SHTETIT

12. Tradhti e lartë Neni 305	Dyshim se me përdorim të fuqisë dhe kërcënimit serioz është kryer përpjekje për ndryshim të rendit kushtetues (sundim i pakicës përkundrejt shumicës) apo përpjekje që të rrëzohet Kuvendi si një prej organeve më të larta shtetërore. <u>Përgjegjësi</u> : organizatorët dhe kryerësit <u>Dënimi</u> : burgim prej minimum 5 vjetësh
13. Dhunë kundër përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore Neni 311	Dyshim se ekzistonte qëllimi për rrezikim të rendit kushtetues ose sigurisë së shtetit me kërcënim të lartë që Kryetari i ri i zgjedhur i Kuvendit të pengohet në kryerjen e obligimit të tij. <u>Përgjegjësi</u> : organizatorët <u>Dënimi</u> : burgim prej minimum 4 vjetësh
14. Rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe	Dyshim se ekzistonte qëllim të rrezikohet rendi

<p>sigurisë</p> <p>Neni 313</p>	<p>kushtetues dhe siguria e shtetit nëpërmjet kërcënimeve serioze dhe me akt të dhunës, gjatë të cilit është krijuar ndjenja e pasigurisë dhe frikës te qytetarët. Dyshimi është përforcuar me gjetjen e bombës së improvizuar në Kuvend, e bërë nga një bocë gazi dhe materiale piroteknike.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: organizatorët dhe kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim prej minimum 10 vjetësh</p>
<p>15. Sabotim</p> <p>Neni 315</p>	<p>Dyshim se një pjesë e deputetëve në kryerjen e obligimit të vet të punës me qëllim që ta rrezikojnë rendin kushtetues dhe sigurinë e shtetit në mënyrë të fshehtë dhe qëllimkeqë shkaktuan dëm të theksuar për Kuvendin. Dyshimi del nga video-xhirimet ku shihet se si deputetët me vetëdije e hapën derën e Kuvendit, komunikonin me organizatorët dhe kryerësit dhe i drejtonin gjatë lëvizjes së tyre.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: deputetët-kryerës</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim prej minimum 4 vjetësh</p>
<p>16. Bërje thirrje për ndryshim me dhunë të rendit kushtetues</p> <p>Neni 318</p>	<p>Dyshim se ekzistonte qëllimi që të rrezikohet rendi kushtetues dhe siguria e shtetit duke bërë thirrje dhe nxitje publike për kryerje të drejtpërdrejtë apo mbështetje për kryerje të veprave nga pika 13-15 në këtë tekst. Dyshimi del nga publikimet në rrjetet sociale të organizatorëve të protestës “Për Maqedoni të përbashkët” dhe nga retorika gjatë protestave.</p> <p>Përgjegjësi: organizatorët dhe kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim prej 3 muajsh deri në 5 vjet</p>
<p>17. Shkaktim i urrejtjes, përçarjes ose mostolerancës</p> <p>Neni 319</p>	<p>Dyshim se nëpërmjet detyrimit, keqtrajtimit dhe rrezikimit të sigurisë është shkaktuar dhe ndezur urrejtja, përçarje dhe mostoleranca në bazë të përkatësisë politike dhe etnike për shkak të së cilës kanë ndodhur trazira dhe dhuna kundër njerëzve dhe dëmi i pronës në shkallë më të madhe. Vërtetimi i këtij dyshimi do të nënkuptonte se një pjesë e veprave penale janë vepra nga urrejtja, që përbën rrethanë vështirësuese për kryerësit e mundshëm.</p> <p>Përgjegjësi: organizatorët dhe kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim prej 1 deri në 10 vjet</p>

<p>18. Fshehje dhe ndihmë e kryerësit pas veprës penale të kryer</p> <p>Neni 325</p>	<p>Dyshim se kryerësit e mundshëm të veprave penale nga pika 12-15 në këtë tekst janë ndihmuar, u është dhënë strehim, janë përdorur për të mbajtur lidhje dhe janë ndërmarrë veprime për ndalimin e zbulimit dhe kapjes së tyre. Dyshimi del nga gjetjet se një pjesë e të dyshuarve që janë arrestuar atë mbrëmjen janë liruar gjatë rrugës për në stacionin policor dhe se një pjesë e video-xhirimeve të kamerave të sigurisë janë shkatërruar.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: organizatorët, nëpunësit policorë dhe udhëheqësit e nëpunësve policorë</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim prej 1 deri në 10 vjet</p>
---	---

VI. VEPRA PENALE KUNDËR OBLIGIMIT ZYRTAR

<p>19. Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar</p> <p>Neni 353</p>	<p>Dëshmitë dalin nga fotot dhe video-materialet ku shihen nëpunës policorë të cilët e keqpërdorin pozitën dhe autorizimin e vet zyrtar, duke mos kryer obligimin zyrtar dhe duke shkaktuar shkelje më të rëndë të të drejtave të viktimave dhe dëm të madh mbi pronën e Kuvendit.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: nëpunësit policorë dhe udhëheqësit e nëpunësve policorë (nëse kanë dhënë urdhër të paligjshëm)</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim nga 6 deri në 5 vjet</p>
<p>20. Moszbatim i urdhrit</p> <p>Neni 353-b</p>	<p>Dyshim se nëpunësit policorë gjatë kryerjes së obligimit që lidhet me ndalimin dhe zbulimin e veprave penale, kapjen e kryerësve dhe mirëmbajtjen e rendit publik, qetësisë dhe sigurisë së shtetit nuk kanë kryer apo kanë refuzuar të zbatojnë urdhër të udhëheqësit që të ndërmarrin veprime zyrtare, prandaj dhe ka ndodhur shkelje e rëndë e të drejtave të të pranishmëve në Kuvend, prishje më e rëndë i rendit publik dhe qetësisë dhe dëmtim më i rëndë i pronës. Nuk ka vepër penale nëse nëpunësit policorë kanë refuzuar të zbatojnë urdhër të paligjshëm dhe në këtë rast nëpunësi udhëheqës mban përgjegjësi sipas pikës 19 në këtë tekst.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: nëpunësit policorë dhe udhëheqësit e nëpunësve policorë</p>

	<u>Dënimi</u> : burgim nga 3 muaj deri në 3 vjet
--	--

VII. VEPRA PENALE KUNDËR GJYQËSORIT

<p>21. Mosparaqitja e veprës penale ose kryerësit</p> <p>Neni 364</p>	<p>Dyshim se nëpunësit policorë dhe deputetët anashkaluan me vetëdije të paraqesin vepra penale të cilat i kanë mësuar gjatë ushtrimit të obligimit të vet kur për ato vepra mund të shqiptohet dënim me burgim prej pesë vjetësh ose dënim më i rëndë (shiko pikat 1, 12-18 dhe 19-22 dhe 26 në këtë tekst).</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: nëpunësit policorë, udhëheqësit e nëpunësve policorë, deputetët dhe të punësuarit në Kuvend.</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim prej 1 deri në 3 vjet</p>
--	--

VIII. VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK

<p>21. Pengim i personit zyrtar në zbatimin e veprimit zyrtar</p> <p>Neni 382</p>	<p>Dyshim se nëpunësit policorë, nëpërmjet keqtrajtimit, ofendimeve, fuqisë apo kërcënimeve serioze për sul mbi jetën ose trupin e tyre, janë penguar në zbatimin e shërbimit.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: organizatorët, udhëheqësit e nëpunësve policorë, kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: dënim me të holla ose burgim prej 3 vjetësh</p>
<p>22. Sulm mbi person zyrtar gjatë zbatimit të punëve të sigurisë</p> <p>Neni 383</p>	<p>Dëshmitë dalin nga lëndimet e konstatuara te nëpunësit policorë apo personat të cilat ndihmojnë gjatë zbatimit të punëve të sigurisë publike apo mbrojtjes së rendit kushtetues (sigurimi i Kuvendit dhe truprojave).</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: organizatorët dhe kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: dënim me të holla ose burgim prej 3 vjetësh ose deri në 5 vjet nëse ka pasur keqtrajtimit, ofendim dhe lëndim trupor</p>
<p>23. Pjesëmarrje në turmë e cila do të pengojë personin zyrtar në kryerjen e veprimeve zyrtare</p> <p>Neni 384</p>	<p>Dëshmitë dalin nga fotot dhe video-materialet dhe dëshmitë e personave që morën pjesë në turmë që me veprim të përbashkët pengoi apo u përpoq të pengojë nëpunësit policorë në kryerjen e veprimeve zyrtare.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: organizatorët dhe kryerësit</p>

	<u>Dënimi</u> : burgim prej 1 deri në 3 vjet për kryerësit dhe deri në 5 vjet për organizatorët (udhëheqësit e turmës)
24. Pjesëmarrje në turmën që do të kryejë vepër penale Neni 385	Dëshmitë dalin nga fotot dhe video-materialet dhe dëshmitë e personave që morën pjesë në turmë që me veprim të përbashkët zbatoi dhunë kundër njerëzve dhe dëmtoi dhe shkatërroi pronë me vlerë më të madhe. <u>Përgjegjësi</u> : organizatorët dhe kryerësit <u>Dënimi</u> : dënim me të holla ose burgim prej 3 deri në 5 vjet nëse ndonjë person është lënduar më rëndë ose është shkaktuar dëm me shkallë të mëdha, deri në 10 vjet për organizatorit (udhëheqësin e turmës).
25. Dhunë Neni 386	Dëshmitë dalin nga fotot dhe video-materialet dhe dëshmitë për personat që keqtrajtuuan, ofenduan rëndë, e rrezikuan sigurinë e të pranishmëve në Kuvend apo ushtruan mbi ta dhunë të ashpër dhe kështu shkaktuan në publik ndjenjë të pasigurisë, rrezikim dhe frikë. <u>Përgjegjësi</u> : organizatorët dhe kryerësit <u>Dënimi</u> : burgim prej 3 muajsh deri në 3 vjet për dhunë prej një personi, deri në 5 vjet për organizatorin ose nëse është ushtruar nga dy apo më tepër persona mbi më tepër të pranishëm në Kuvend, kanë ndodhur rrahje, trazira dhe dëmtime të pronës në vlerë më të madhe apo është shkaktuar lëndim trupor dhe deri në 10 vjet nëse është shkaktuar lëndim i rëndë trupor.
26. Shoqërim kriminal Neni 394	Dyshim se për trazirat në Kuvend është krijuar bandë apo grup që ka pasur për qëllim kryerjen e veprave penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burg prej tre ose më tepër vitesh. Dyshimi del nga sulmuesit e maskuar dhe të koordinuar, orientimi i tyre në ndërtesën e Kuvendit, veprimin e organizuar dhe lidhjet e vendosura me një pjesë të nëpunësve policorë. <u>Përgjegjësi</u> : organizatorët dhe kryerësit <u>Dënimi</u> : burgim prej 1 deri në 10 vjet për organizatorin (krijuesin e grupit) dhe prej 6 muaj deri në 5 vjet për përfaqësuesin e grupit.
27. Shpërndarje të materialit racor dhe ksenofobik nëpërmjet sistemit kompjuterik Neni 394-ç	Dyshim se disa prej të pranishmëve në Kuvend dhe persona të tjerë, nëpërmjet sistemit kompjuterik në publik kanë shpërndarë material të shkruar racor dhe ksenofobik, fotografi dhe prezantime të tjera të ideve

	<p>ose teori të cilat ndihmuan, promovuan apo nxitën urrejtje, diskriminim dhe dhunë kundër personave dhe grupeve të caktuara, në bazë të përkatësisë etnike dhe politike. Dyshimi del nga materialet që shpërndahen nëpër rrjetet sociale dhe për shkak të tyre kanë ndodhur trazirat dhe dhuna kundër njerëzve dhe ka ndodhur dëmtim i pronës në shkallë të mëdha.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: organizatorët dhe kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim prej 1 deri në 10 vjet</p>
<p>28. Përpunim dhe furnizim me armë dhe mjete për kryerje të veprave penale</p> <p>Neni 395</p>	<p>Dëshmi është gjetja e bombës së improvizuar të bërë nga një bombol gazi dhe materiale piroteknike në Kuvend. Bomba duket qartë që është bërë që të kryhet vepër penale kundër të pranishmëve në Kuvend dhe të shkaktojë dëm të theksuar material.</p> <p><u>Përgjegjësi</u>: organizatorët dhe kryerësit</p> <p><u>Dënimi</u>: burgim prej 1 deri në 5 vjet</p>

Në përputhje me nenin 273 paragrafin 3 të Ligjit për Procedurë Penale, secili mund të paraqitet për vepër penale e cila ndiqet me obligim zyrtar. Me dorëzimin e këtij raporti të veçantë në Prokurorinë Themelore Publike dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kërkohet që të ngrihet procedurë parahetimore për përcaktimin e përgjegjësisë penale për veprat penale të përfshira në këtë Raport, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurë Penale.